



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHE

Nr. _____ Prot.

Lezhë, më ____/____/2025

Shtojca 12.

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

Data 01/08/2025

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE) ☐ ose

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) X

Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “PRO GREEN” Shpk, me Nuis M11517040F, me adrese Rruga "Kavajes", Qendra "Sun Tower", Kati 9, Ap.38, Tirane & “L.T.E CONSTRUCTION” Shpk, me Nuis L78006801F, me adrese Rruga 3 Deshmoret, Kompleksi Grand, Apartamenti F-2-08, Kati 1, Kashar, Tirane,

- OE “PRO GREEN” Shpk, me Nuis M11517040F dhe me pjesëmarrje prej 27 %,
- OE “L.T.E CONSTRUCTION” Shpk, me Nuis L78006801F dhe me pjesëmarrje prej 73 %,

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** **X**

OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO **X** **JO** ☐

Operatori Ekonomik “FLED” Shpk, me Nuis K17621104C dhe me adrese Lagjja “Havaleas”, Rruga “Ura e kozares” Kuçovë, godinë private 1- katëshe, Nr.307, Havalehas, Kozare, Berat,

Tipi i Kontratës: Pune.

Lloji i Procedurës së prokurimit: E Hapur e Thjeshtuar

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: REF-54165-07-10-2025

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Rehabilitimi i Rrugës së varrezave Rras i Butë”.

Kohëzgjatja e kontratës: 3 muaj nga data nënshkrimit të kontratës.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 18.07.2025.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletin e Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 37 datë 21 Korrik 2025

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “ASI INVEST” Shpk, me Nuis M01927023H dhe me oferte ekonomike 5,863,410 (pese milion e teteqind e gjashtedhjetë e tre mijë e katerqind e dhjetë) Lek pa Tvsh,

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

2. Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “PRO GREEN” Shpk, me Nuis M11517040F & “L.T.E CONSTRUCTION” Shpk, me Nuis L78006801F dhe me oferte ekonomike 8,313,322.5 (tete milion e treqind e trembedhjetë mijë e treqind e njezet e dy pike pese) Lek pa Tvsh,

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

I- Operatori Ekonomik “ASI INVEST” Shpk, me Nuis M01927023H,

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se BOE ka dorezuar te gjithë dokumentacionin ne perputhje me kriteret e pergjithshme dhe te vecanta te kualifikimit te percaktuar ne dokumentat standarte te tenderit.

Komisioni i vleresimit te ofertave mbeshetur në nenin 92, pika 3, ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, ku parashikohet shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

Per sa me siper oferta e dorezuar nga Operatori Ekonomik “ASI INVEST” Shpk, me Nuis M01927023H, eshte kualifikuar.

Ne vijim, Komisioni i Vleresimit te Ofertave pas kualifikimit te 2 ofertave te vlefshme bazuar ne ligjin nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020“Për prokurimin publik”, ne nenin 27, ku percaktohet se: *“Në nenin 93 pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje: “5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët”, si dhe nenin 82/4, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:*

- Në rastin kur janë të vlefshme **dy ose më pak oferta**, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se **25% e fondit limit** të përlllogaritur;
- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

verifikoi 2 ofertat e kualifikuara te vlefshme nëse janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit ku rezulton se fondi limit eshte 9,166,658.88 Lek pa TVSH dhe 25% me e ulet se fondi limit eshte vlere prej 6,874,994,16, dhe cdo oferte me vlere me te ulet se vlere prej 6,874,994,16 lek **konsiderohet anomalisht e ulet dhe duhet refuzuar pa kerkuar shpjegime** sipas ligjit nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020“Për prokurimin publik”.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave krahasoi vlerat e 2 ofertave te vlefshme me vleren e 75% te fondit limit ku nga krahasimi i ketyre ofertave rezultoi se oferta e paraqitur nga “ASI INVEST” Shpk, me Nuis M01927023H, me vlere prej 5,863,410 Lek pa Tvsh, eshte ulur **36% nga fondi limit** dhe per rrjedhoje **eshte anomalisht e ulet dhe duhet refuzuar pa kerkuar shpjegime** bazuar kjo ne nenin 27, te ligjin nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020“Për prokurimin publik”, si dhe nenin 82/4, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë

që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “ASI INVEST” Shpk, me Nuis M01927023H, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, e OE “ASI INVEST” Shpk, me Nuis M01927023H, skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatoreve Ekonomik “PRO GREEN” Shpk, me Nuis M11517040F, me adrese Rruga "Kavajes", Qendra "Sun Tower", Kati 9, Ap.38, Tirane & “L.T.E CONSTRUCTION” Shpk, me Nuis L78006801F, me adrese Rruga 3 Deshmoret, Kompleksi Grand, Apartamenti F-2-08, Kati 1, Kashar, Tirane, përfaqësuar nga OE “PRO GREEN” Shpk se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 8,313,322.5 (tete milion e treqind e trembedhjetë mijë e treqind e njezet e dy pike pese) Lek pa Tvsh është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

**KRYETARI
Pjerin NDREU**